

PEZULLIMI I LEJES SË QARKULLIMIT

-kur perdoret një mjet për një destinacion të ndryshëm nga ajo e treguar në kartën e qarkullimit nga 1-6 muaj;

-kur përdoret një mjet për transport njerëzish(minibus ose autobus) pa autorizimin e duhur nga 1-6 muaj;

-kur përdoret për shërbim të linjës një mjet jo i destinuar për këtë qëllim(p.sh mjet për transport malli) apo kur përdoret një mjet në linja të ndryshme nga ato të autorizuara 1-6 muaj;

-kur transportohen mallra të rrezikshme pa respektuar kushtet e parashikuara në ambalazhim, etiketim, në ngarkim, në shkarkim apo transportohen mallra të rrezikshme pa autorizim të rregullt ose pa respektuar normat e përcaktuara nga drejtuesi vetë nga 6-12 muaj;

-kur drejtohen mjete të destinuara për transport njerëzish, me përjashtim të autoveturave, me një numër personash më të madh se ajo e lejuar nga 6-12 muaj;

-kur shkelen kufijtë e masës dhe të përmasave të mjetit nga 3-6 muaj.